

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ZHVILLOI VIZITË PUNE NË KOSOVË *Faqe 2*

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani, i shoqëruar nga një delegacion nga trupa inspektuese e ILD-së, zhvilloi një vizitë pune në Prishtinë, ku pati takime me drejtues të institucioneve të drejtësisë dhe trupën akademike të Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Prishtinës.



ILD në shifra

92 vendime nga 149 praktika të trajtuara

- 80 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar
- 12 vendime arkivimi pas verifikimit

22 vendime verifikimi

2 vendime për mbyllje hetimi disiplinor për 2 magjistratë (1 gjyqtar, 1 prokuror)

2 inspektime tematike

Qytetari në Zyrën e ILD-së

Gjatë muajit Janar 2026:

- janë pritur **27 ankes**, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- janë realizuar **18 telefonata** me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.
- janë trajtuar **14 kërkesa** për informacion.



ILD për bashkëpunimin me eu4justice: Të shndërrojme çdo praktikë të mirë pune në standard të qëndrueshëm
Fq. 3-4



Stafi i ILD-së trajnim për përdorimin e inteligjencës artificiale në sistemin e drejtësisë
Fq. 5-6

Trupa e inspektimit të ILD, trajnim mbi metodologjinë për verifikimin e aseteve
Fq. 7-8

Njoftim për media për përfundim verifikimi të nisur kryesisht
Fq. 9-10

Një ekip inspektimi i ILD, vizitë studimore në Spanjë për mbikëqyrjen disiplinore
Fq. 11

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ZHVILLOI VIZITË PUNE NË KOSOVË



Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani, i shoqëruar nga një delegacion nga trupa inspektuese e ILD-së, zhvilloi një vizitë pune në Prishtinë, ku pati takime me drejtues të institucioneve të drejtësisë dhe trupën akademike të Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Prishtinës.

Në takimin e zhvilluar me kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, z. Fejzullah Rexhepi dhe gjyqtarin e Gjykatës Supreme, z. Qerim Ademaj, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani u ndal si fillim tek roli dhe funksionet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me trajtimin e ankesave, hetimet disiplinore dhe inspektimet ndaj magjistratëve.

Kryetari i Gjykatës Supreme e informoi Inspektorin e Lartë të Drejtësisë rreth funksioneve të Gjykatës që drejton, si dhe kompetencën që Gjykata Supreme ka në trajtimin e ankesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë, ndaj vendimeve të Komisioneve Disiplinore të Këshillave përkatës. Z. Metani dhe z. Rexhepi vlerësuan se ndërtimi dhe thellimi i marrëdhënieve profesionale mes dy institucioneve kontribuon në promovimin e standardeve etike dhe profesionale në sistemet e drejtësisë së dy vendeve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe delegacioni që e shoqëronte zhvilloi një takim pune në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ku u mikprit nga kryesuesi i Këshillit Gjyqësor z. Albert Zogaj, zëvendëskryesuesja e këtij Këshilli znj. Arjeta Sadiku, kryetarja e Komisionit të Performancës së gjyqtarëve znj. Teuta Brahimi, si dhe drejtori i përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Shkëlzen Maliqi.

Z. Metani e falenderoi z. Zogaj për pjesëmarrjen dhe angazhimin në konferencën rajonale të shërbimeve të inspektimit, që u mbajt në Tiranë në 25-26 shtator 2025, vlerësoi bashkëpunimin ndërinstitucional, duke theksuar rëndësinë e shkëmbimit të praktikave më të mira profesionale dhe të përvojave institucionale. Duke vlerësuar si të shkëlqyer bashkëpunimin ndërinstitucional, Kryesuesi Zogaj e informoi Inspektorin e Lartë të Drejtësisë mbi zhvillimet brenda sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës, përfshirë proceset reformuese, avancimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe integritetit, si dhe sfidat me të cilat përballet Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Të dy bashkëbiseduesit ranë dakord për intensifikimin e bashkëpunimit dhe zhvillimin e iniciativave të përbashkëta në të ardhmen, edhe përmes shkëmbimeve profesionale në institucionet respektive.

Një ndalesë e posaçme e vizitës së punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në Kosovë ishte në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit "Hasan Prishtina", me të cilin ILD ka një marrëveshje bashkëpunimi, që në tetor të vitit 2022.

Në takimin me dekanin e Fakultetit të Drejtësisë z. Avni Puka dhe trupën akademike të këtij Fakulteti, u konsiderua si mjaft produktiv bashkëpunimi i deritanishëm, sidomos me vizitat studimore të studentëve të Fakultetit Juridik të Prishtinës në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe u hodhën ide për bashkëpunime në të ardhmen, si një trashëgimi e brezave, por edhe e konsolidimit të institucioneve të drejtësisë, pasi studentët e sotëm janë pjesa e ardhme e sistemit në Kosovë.



ILD PËR BASHKËPUNIMIN ME EU4JUSTICE: TË SHNDËRROJMË ÇDO PRAKTIKË TË MIRË PUNE NË STANDARD TË QËNDRUESHËM



Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mori pjesë në konferencën përmbyllëse të projektit EU4Justice “Duke reflektuar mbi arritjet dhe duke parë përpara me institucionet e pavarura të drejtësisë dhe partnerët në Shqipëri” që bëri bashkë drejtues e përfaqësues të institucioneve të drejtësisë, partnerë ndërkombëtarë, përfaqësues të ekzekutivit, profesionistë të së drejtës etj., për të evidentuar arritjet kryesore, për të nxjerrë në pah përparësitë strategjike bazuar në mësimet e nxjerra dhe për të siguruar mbështetje dhe angazhim të dukshëm, nga partnerët dhe aktorët institucionale për mbështetjen e reformave.

Inspektori i lartë i Drejtësisë u përfaqësua në konferencë nga Sekretari i Përgjithshëm i ILD-së, znj. Dëshira Pasko, e cila përcolli disa reflektime të institucionit mbi bashkëpunimin gati 3 vjeçar me EU4Justice.

Fjala e plotë e mbajtur nga znj. Pasko:

Të nderuar shkëlqesi ambasadorë,

Të nderuar drejtues të institucioneve të drejtësisë,

Të nderuar pjesëmarrës,

Kam kënaqësinë të përcjell para jush në emër të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë z. Artur Metani, disa reflektime mbi bashkëpunimin, që institucioni ynë ka pasur me programin e Bashkimit Evropian për drejtësinë, EU4Justice, përmbyllja e të cilit na ka bërë bashkë të gjithëve sot.

Duke qenë unik në llojin e vet, pasi për herë të parë, inspektimi i gjyqtarëve e prokurorëve të të gjitha niveleve bëhet nga një institucion i vetëm, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka synuar që në nisje të veprimtarisë së vet, krijimin e një kulture pavarësie, profesionalizmi dhe efektiviteti, si një sfidë profesionale, përveçse detyrim ligjor. Në këtë rrugëtim për ngritjen e forcimit e kapaciteteve, konsolidimin e praktikës së inspektimit e hetimit disiplinor, bazuar në procedura transparente e profesionale, në përputhje me standardet e praktikat më të mira ndërkombëtare dhe vendosjen e forcimit e standardeve në sistem dhe efikasitetin e drejtësisë, jemi asistuar nga partnerë ndërkombëtarë, të cilëve u jemi mirënjohës.

Asistenca profesionale e Bashkimit Evropian, dikur me misionet EURALIUS e deri tek programi EU4Justice ka qenë gjithmonë e rëndësishme në mbështetjen e institucioneve shqiptare të drejtësisë, në zbatimin e reformave që sigurojnë rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë në vendin tonë dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka qenë një nga përfituesit, që eksperiencën e marrë e ka përkthyer në efikasitet në veprimtarinë e vet të përditshme.

Duke iu përgjigjur nevojave të ILD-së, bazuar në prioritetet strategjike të institucionit, EU4Justice ka qenë një partner prezent, që ka ofruar në vijimësi mbështetje teknike përmes aktiviteteve të targetuara profesionale për institucionin tonë.

Trajnimi i vazhdueshëm i trupës së inspektimit në veçanti, por edhe i stafit të ILD-së në përgjithësi është një filozofi pune e ILD-së, për forcimin sistematik të kapaciteteve, çka passjellë rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së institucionit. Asistenca e EU4Justice ka qenë e çmuar përmes trajnimeve të trupës së inspektimit të ILD-së mbi dimensione të ndryshme pune, si trajtimi i ankesave, hetimi disiplinor, inspektimi institucional e tematik, çështje të etikës e pavarësisë së magjistratëve, por edhe shkëmbim eksperiencash me homologë nga vende të Bashkimit Evropian.

Kështu, përvoja spanjolle, ajo italiane dhe franceze e EU4Justice kanë shërbyer jo vetëm në forcimin e kapaciteteve të institucionit, por edhe në rritjen dhe rritje vizibiliteti përmes angazhimit ndërkombëtar të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si anëtar i Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë, RESIJ.

Me vlerë të posaçme kanë qenë edhe takimet e përbashkëta me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe institucione të tjera të drejtësisë, mbi sfida specifike pune për rritjen e koordinimit e komunikimit institucional, të mbështetura nga EU4Justice.

Ky program i Bashkimit Evropian ka asistuar ILD-në edhe në diskutim e hartim dokumentesh pune, bazuar në modele e praktikat më të mira evropiane, e deri tek botimi më i fundit historik mbi inspektimin gjyqësor, me sfidat dhe arritjet e këtij procesi në 113 vite të shtetit shqiptar, janë mjete që ndihmojnë veprimtarinë, por edhe shënojnë memorien jo vetëm të institucionit, por edhe të çdo profesionisti të së drejtës në punën e vet.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR

Në këtë frymë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbetet e interesuar që kjo asistencë të vijojë.

Në këndvështrimin tonë, kjo është e rëndësishme:

Së pari për tejkalimin e sfidave, që sistemi i drejtësisë ka ende përpara,

së dyti, për konsolidimin e arritjeve të deritanishme,

së treti për shndërrimin e çdo praktike të mirë në standard të qëndrueshëm, që do i shërbejë forcimit të besimit të qytetarëve tek drejtësia e institucionet,

e së katërti, jo më pak e rëndësishmja, për ndikimin e fortë që do të ketë efikasiteti i institucioneve të drejtësisë në anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Dhënia e drejtësisë në kohë, në mënyrë efektive, transparente e me cilësi, mbetet një proces sfidues sot edhe për vetë vende të Bashkimit Evropian. Pra edhe në rastin e Shqipërisë kërkon kohën e vet, kërkon përkushtim nga çdo institucion e aktor publik, e padyshim edhe partnerë mbështetës, si Bashkimi Evropian.

Ju faleminderit për vëmendjen!



STAFI I ILD-SË TRAJNIM PËR PËRDORIMIN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË SISTEMIN E DREJTËSISË



Stafi i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përfshi inspektorë, ndihmës inspektorë, anëtarë të kabinetit dhe nëpunës të administratës, mori pjesë në një trajnim njëditor mbi përdorimin e teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë, si dhe rolin e saj në veprimtarinë e gjykatave dhe prokurorive. Trajnimi u zhvillua me mbështetjen e projektit CEPEJ të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për Efikasitetin e Drejtësisë (SEJ IV).

Në emër të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Sekretari i Përgjithshëm, znj. Dëshira Pasko, në fjalën e saj përshëndetëse në hapje të trajnimit, shprehu falënderimet për mbështetjen e vazhdueshme të projektit të Këshillit të Evropës dhe Komisionit Evropian për efikasitetin e drejtësisë (CEPEJ), i cili prej vitesh asiston Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në procesin e forcimit të kapaciteteve institucionale në fushën e inspektimit, hetimit disiplinor, etikës dhe pavarësisë së magjistratëve. Ajo theksoi se ky trajnim ka një rëndësi të veçantë për njohjen me udhëzimet e CEPEJ, si dhe me praktikën e mira dhe kufijtë e përdorimit të inteligjencës artificiale në sistemin gjyqësor.

Në emër të SEJ, oficerja e lartë e projektit, znj. Laurela Muça tha se “Ky trajnim, i iniciuar nga ILD, i paraprin përdorimit në rritje të IT-së dhe inteligjencës artificiale, duke adresuar edhe çështjet etike të përdorimit të tyre në gjyqësor.”

Eksperti i CEPEJ Marek Swierczynski paraqiti në fillim kuadrin e përgjithshëm të përdorimit të teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë, rolin e saj në veprimtarinë e gjykatave dhe prokurorive, si dhe aplikimet e inteligjencës artificiale në sistemet gjyqësore.

Trajnimi u fokusua edhe tek etika në inteligjencën artificiale në sistemin e drejtësisë, transparenca, përgjegjshmëria dhe gjurmueshmëria në përdorimin e inteligjencës artificiale, si dhe ruajtja e pavarësisë së gjyqësorit dhe e rolit vendimmarrës të gjyqtarit gjatë përdorimit të mjeteve të inteligjencës artificiale.

Në sesionin mbi praktikën e mira dhe standardet ndërkombëtare, stafi i ILD-së u njoh me standardet dhe instrumentet e Këshillit të Evropës, karta Etike Evropiane e CEPEJ për përdorimin e inteligjencës artificiale në sistemet gjyqësore dhe mjedisin e tyre, si dhe udhëzimet për përdorimin e inteligjencës artificiale gjeneruese nga gjykatat.

Në sesionin përmbyllës diskutimet u fokusuan tek implikimet etike dhe profesionale të përdorimit të mjeteve të inteligjencës artificiale në hartimin e pjeshëm të një vendimi gjyqësor.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË
BULETINI MUJOR



TRUPA E INSPEKTIMIT TË ILD, TRAJNIM MBI METODOLOGJINË PËR VERIFIKIMIN E ASETVE



Njësia e Inspektorëve dhe ndihmësinpektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvilloi një takim dy ditor në Tiranë, mbi forcimin e kapaciteteve teknike dhe operacionale të stafit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD), për zbatimin efektiv të Metodologjisë së Verifikimit të Pasurisë në mënyrë të qëndrueshme, transparente dhe metodologjikisht të saktë, mbështetur nga projekti EU4Justice.

Drafti i metodologjisë është një dokument i përgatitur nga Kolonel Lejtnant Alberto De Ventura nga Guardia di Finanza, për verifikimin e asetve, bazuar në kuadrin ligjor ekzistues, praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe përvojat e provuara, duke mbështetur Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në kryerjen e vlerësimeve në ushtrimin e funksioneve të tij, bazuar në standardet dhe praktikën më të mirë ndërkombëtare në përputhje me kuadrin aktual ligjor kombëtar dhe mësimet e nxjerra nga procesi i vettingut.

Dokumenti do të shërbejë si një udhëzues praktik për inspektorët e ILD-së, duke përcaktuar standarde dhe procedura të qarta për verifikimin e konsistencës,

ligjshmërisë dhe integritetit etik të deklaratave të pasurisë.

Eksperti i i EU4Justice, Kolonel Lejtnant De Ventura paraqiti draftin e metodologjisë, duke e vënë theksin tek mënyra, sesi duhet të vepohet në rastet e korrupsionit të niveleve të larta.

Kjo qasje ndërvepruese dhe e orientuar drejt praktikës do të synojë dhe mundësojë përshtatjen e mëtejshme të metodologjisë aty ku është e nevojshme, pa cenuar parimet e saj thelbësore, duke forcuar njëkohësisht gjykimin profesional, garancitë procedurale dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të njohura në fushën e verifikimit të pasurisë.

Trajnimi dyditor u zhvillua në 6 sesione, duke filluar me një pasqyrë të metodologjisë për verifikimin e asetve, kontrollin e tyre, metodat më të zakonshme për fshehjen e asetve, pronësisë, apo origjinës, si dhe procedurat që nisin me burimet e elementeve provuese, vërtetimi i provave e të tjera.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR



NJOFTIM PËR MEDIA PËR PËRFUNDIM VERIFIKIMI TË NISUR KRYESISHT



Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përfunduar verifikimin e nisur kryesisht, të informacionit të bërë publik në media, ku ngrihen pretendime për shkelje etike, parashikuar nga neni 102, pika 2, gërma “dh” e ligjit nr. 96/1016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nga ana e prokurorit z. Gjergj Ceka dhe nga ana e gjyqtarës znj. Megi Strakosha, me avokatin z. Ulian Bajrami, gjatë debatit të zhvilluar në seancën e datës 17.10.2025 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit M. L. (S.), që përfundoi me arrestimin e avokatit.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson paraprakisht se faktet (veprimet apo mosveprimet e magjistratit), të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, nuk janë vetëm ato që parashtrihen në bazë të një informacioni publik, por janë ato që analizohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, apo vlerësohen në bazë të një procesi verifikimi apo hetimit disiplinor. Në bazë të një informacioni publik mund të paraqiten një tërësi faktesh, të cilat pretendohet se kanë ndodhur dhe që përbëjnë shkelje disiplinore, por Inspektori i Lartë i Drejtësisë, mund të bëjë një cilësim të saktë apo të ndryshëm të fakteve dhe veprimeve, që lidhen me shkeljen disiplinore, pa u lidhur me përcaktimin, që mund të pretendohet në këtë informacion publik.

Në kuadër të verifikimit të këtij rasti, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, kopje të procesverbalit të seancës gjyqësore, ku kanë qenë të pranishëm 14 persona, për të cilët do të vleftësohej ligjshmëria e arrestimit në flagrancë dhe do të caktohej masa e sigurimit personal. Debatit ndërmjet avokatit dhe prokurorit me pyetje, përgjigje dhe ndërhyrje të shpeshta të ndërsjellta ndërmjet tyre, ka nisur pas pyetjes së personit nën hetim M. L. (S.), i cili mbrohej nga avokat Ulian Barjami. Debatit ndërmjet avokatit dhe prokurorit, i shoqëruar herë pas here edhe me ndërhyrjen e personit nën hetim M. S., ka patur si fokus “shprehjet/fjalët e thëna nga personi nën hetim shtetas M. S., ndaj punonjësve të policisë në momentin e kapjes në flagrancë”, që përfshinin edhe shprehje kërcënuese me jetë. Debat (pyetje, përgjigje, ndërhyrje) është zhvilluar edhe ndërmjet avokatit dhe gjyqtarës së çështjes, për të sqaruar kontekstin e përdorimit të këtyre shprehjeve/fjalëve ndaj policisë, nga ana e personit nën hetim të mbrojtur prej tij në momentin e kapjes në flagrancë. Debatit përmbante qëndrime nga avokati, se do të merrej personalisht me prokurorin e të gjithë oficerët e policisë dhe kundërpërgjigjen e prokurorit, se avokati do arrestohej për këto deklarime. Rezulton që gjyqtarja t’i ketë tërhequr vëmendjen avokatit dhe prokurorit lidhur me etikën në sjellje ndaj njëri-tjetrit e për t’u fokusuar tek faktet, duke nënvizuar se janë ato që bindin gjykatën.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR

Në analizë të veprimit e mosveprimit të magjistratit në raport me standardet etike dhe rregullat e sjelljes, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson se dispozitat e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të cilat parashikojnë shkeljet disiplinore, nuk mund të interpretohen në mënyrë të kufizuar, por duhet të interpretohen dhe zbatohen në mënyrë të zgjeruar. Kjo për faktin se nuk është e lehtë të precizohet përmbajtja e saktë e veprimeve/ mosveprimeve (sjelljeve) dhe as nuk ekziston një përkufizim shterues, përveçse ekzistencës së një numri shembujsh të përcaktuar në Standardet e Etikës dhe Rregullave të Sjelljes së Prokurorit.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson se sjellja e magjistratëve mbetet shumë e rëndësishme, pasi magjistrati duhet të ketë besim të plotë, duhet të jetë i ndërgjegjshëm se funksioni dhe i roli i tij nuk mund të jetë thjesht një profesion, por është një model sjellje apo mënyrë jetese, që mbart vlera, të cilat jo vetëm duhet të transmetohen, por edhe të shfaqen në publik gjatë gjithë kohës. Për këtë arsye, magjistratët duhet të sillen dhe veprojnë në çdo kohë në përputhje me vlerat etike dhe morale.

Nga verifikimi i rastit:

- Rezultoni që prokurori të mos jetë vetëpërmbajtur dhe të ketë shkelur rregullat e solemnitetit dhe etikën në komunikim. Marrja e fjalës disa herë në seancë pa lejen e gjykatës, pavarësisht se është formë reagimi e nxitur nga thëniet dhe shprehjet e avokatit, nuk ka qenë në nivelin më të lartë të standardeve etike. Standardet etike nuk zbatohen vetëm gjatë përmbushjes së detyrave e respektimit të ligjit si çdo person tjetër, por edhe duke u sjellë me integritet, ndershmëri, vetëpërmbajtje dhe diskrecion, si gjatë dhe jashtë ushtrimit të detyrës. Personaliteti i magjistratëve si dhe respektimi në mënyrë strikte i standardeve etike në punë e jashtë saj kanë rëndësi të jashtëzakonshme për besueshmërinë ndaj individëve, pjesëmarrësve në procese gjyqësore, sistemit të drejtësisë në tërësi si dhe vetë autoritetin e institucioneve shtetërore në veçanti.
- Mbahet në konsideratë fakti se shkak i nisjes së debatit dhe fokusi i tij kanë qenë shprehjet e përdorura ndaj policisë nga personi nën hetim në momentin e kapjes në flagrancë, fakti se nga ana e mbrojtësit në debatin me prokurorin janë ngritur ndaj tij akuza të drejtpërdrejta në lidhje me një prej provave e pretenduar si e falsifikuar, (debat gjatë të cilit një shprehje e avokatit është cilësuar nga gjyqtarja si “kërcënim në sallën e gjyqit”), si dhe fakti se situata në vend në këtë periudhë ndaj zyrtarëve të drejtësisë ka qenë e rëndë, për shkak të vrasjes së gjyqtarit A. K.

- Rezultoni se si pasojë e komunikimit jo në nivelin më të lartë të standardeve etike nga ana e magjistratit, nuk ka ardhur ndonjë pasojë konkrete në lidhje me ushtrimin e funksionit të prokurorit, si dhe rolit të tij si magjistrat, si dhe sjellja e prokurorit ka pasur karakter të izoluar dhe ka ndodhur vetëm një herë, si dhe nuk ka krijuar terren për sjellje të papërshtatshme edhe në rastet të tjera të ngjashme. Në të njëjtën kohë, rezultoni se prokurori ka një vjetërsi në detyrë prej 5 vitesh, një periudhë kjo relativisht e shkurtër e përvojës së tij si magjistrat prokuror.

Ndërkohë, lidhur me sjelljen e gjyqtarës znj. Megi Strakosha, gjatë drejtimit të seancës së datës 17.10.2025, nga verifikimi i rastit vlerësohet se nga ana e gjyqtarës znj. Megi Strakosha nuk konstatohet të jenë shkelur rregullat e solemnitetit, rregullat e sjelljes në marrëdhënie me palët apo rregullat e etikës.

- Rezultoni që gjyqtarja t’u ketë tërhequr vëmendjen, si prokurorit ashtu edhe avokatit të palës, rezultoni të ketë kërkuar sqarim të situatës, si nga avokati edhe nga prokurori, si dhe rezultoni të ketë vepruar në përputhje me parashikimet e nenit 341 i K. Pr. Penale, pasi detyrë e saj ka qenë garantimi i respektimit të autoritetit të gjykatës, solemnitetit të gjykimit dhe sigurisë në sallë, si dhe shmangia e çdo fyerjeje, kërcënimi në gjykim dhe kur ajo ka konstatuar veprime që cenojnë solemnitetin e gjykimit, ka paralajmëruar për pasojë, si largimin nga salla të avokatit dhe caktimin e një avokat tjetër kryesisht, nëse avokati do të vijonte me të njëjtin komunikim.

Nga analiza e të dhënave të grumbulluara nga verifikimi, nuk konstatohen paraprakisht elementë juridikë apo faktikë, të cilët i krijojnë Inspektori të Lartë të Drejtësisë një dyshim të arsyeshëm për fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit prokuror z. Gjergji Ceka, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe ndaj magjistrates gjyqtare znj. Megi Strakosha me detyrë gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar. Për këtë shkak, informacioni i bërë publik në media lidhur me pretendimet e ngritura për shkelje etike, duhet të arkivohet bazuar në nenin 122/4 të këtij ligji.

Lidhur me shkeljen e rregullave të etikës nga magjistrati z. Gjergji Ceka, rasti do t’i referohet Këshillit të Lartë të Prokurorisë për t’u marrë në konsideratë në vlerësimin etik-profesional për këtë magjistrat, sipas kërkesave të nenit 77 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

NJË EKIP INSPEKTIMI I ILD, VIZITË STUDIMORE NË SPANJË PËR MBIKËQYRJEN DISIPLINORE



Një ekip inspektimi i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvilloi një vizitë studimore tri ditore në dy zyra prokurorie në Spanjë, me mbështetjen e projektit EU4Justice. Kjo vizitë pune është pjesë e traditës së ILD-së, për forcimin e kapaciteteve profesionale të inspektorëve nëpërmjet trajnimeve dhe shkëmbimit të drejtpërdrejtë institucional, me përvojat e praktikave më të mira të aplikuara nga institucionet homologe në shtetet anëtare të BE-së.

Ekipi i ILD-së, i përbërë nga Inspektoria magjistrate Elsa Miha dhe ndihmës inspektoret Alma Troshani e Mígena Bako, e nisi vizitën studimore në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm në Madrid, ku u mikprit nga përfaqësues të Shërbimit të Inspeksionit të Prokurorisë. Ato u njohën me rolin institucional dhe mandatin e inspektorëve të prokurorisë, llojet e inspeksioneve, mekanizmat e llogaridhënies dhe marrëdhënien midis inspektorëve dhe prokurorëve. Në takim me z. Francisco Moreno Carrasco, Promovues i Përgjithshëm i Veprimeve Disiplinore, u ofrua një pasqyrë të kuadrit ligjor që rregullon mbikëqyrjen disiplinore, procedurat disiplinore dhe llojet e sanksioneve.

Dita e dytë dhe e tretë e vizitës u zhvillua në Zyrën e Prokurorisë Provinciale të Cuencas, ku ekipi i ILD-së ndoqi zbatimin praktik të një inspektimi të prokurorisë, që nga përgatitja tek ekzekutimi i inspeksionit, përfshi planifikimin e inspeksionit, mbledhjen paraprake të të dhënave, metodologjinë e marrjes së dosjeve të rasteve, përdorimin e sistemit elektronik të menaxhimit të rasteve, intervistat me prokurorët dhe stafin administrativ, e deri tek hartimi i gjetjeve të inspeksionit, dallimi midis çështjeve disiplinore dhe jo-disiplinore, formulimi i rekomandimeve dhe mekanizmat e ndjekjes për zbatimin e tyre.

Vizita përfundoi me diskutime mbi mësimet e nxjerra dhe zbatueshmërinë e praktikave më të mira spanjolle në kontekstin institucional shqiptar, për përmirësimin e mekanizmave të mbikëqyrjes disiplinore në Shqipëri, duke promovuar meritokracinë, transparencën, llogaridhënien dhe respektin për pavarësinë dhe procesin e rregullt ligjor brenda sistemit të drejtësisë, në përputhje me standardet e BE-së.



JANARI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit janar 2026 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **149 ankesa**, nga ta cilat **147 ankesa të depozituara nga qytetarë dhe 2 nga institucione**. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit janar 2026.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR	INSPEKTIVE TEMATIKE
<p>92 vendime nga 149 praktika të trajtuara:</p> <ul style="list-style-type: none">· 80 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar· 12 vendime arkivimi pas verifikimit	<p>22 vendime verifikimi</p>	<p>2 vendime për mbyllje hetimi disiplinor për 2 magjistratë (1 gjyqtar, 1 prokuror)</p>	<p>2 inspektive të përfunduara:</p> <ol style="list-style-type: none">1. “Mbi ndarjen e çështjeve me short si dhe kontrollin e raporteve të sistemit elektronik në Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër për periudhën 01.01.2024-31.12.2024”,2. “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve në Prokuroritë Durrës, Vlorë, Dibër për periudhën 01.01.2024-31.12.2024”.

ANKIMI NË ILD

Për të lehtësuar procesin e ankimit për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posaçëm ankesë, i cili:

- mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr. 13, Tiranë;
- mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “Si pranohen ankesat”.



Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00 - 14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217. Pjesë e ekipit është edhe Koordinatorin për të drejtën e informimit.



SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit Janar 2026, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **5 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijën ankuesit.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuesin për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

*Gjatë muajit **Janar 2026**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **14 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkesit t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

ILD NË TWITTER

Inspektori i Larte i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

Gjithmonë kënaqësi takimi në Prishtinë e Tiranë me dekanin e Fakultetit Juridik @UpJuridik z. Avni Puka dhe kolegët e tij. Kemi një bashkëpunim të shkëlqyer dhe shumë plane ambicioze për të ardhmen. #ILD 🇲🇪 🇦🇱 🇪🇺



Inspektori i Larte i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

Kënaqësi personale&profesionale takimet e sotme në me Kryetarin e Gjykatës Supreme, z. Fejzullah Rexhepi dhe Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor z. Albert Zogaj e kolegët e tij. Diskutime të vjera mbi punën& ide për zhvillimin e iniciativave të përbashkëta në të ardhmen. #ILD 🇲🇪 🇦🇱 🇪🇺



Inspektori i Larte i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

Përpunimi javor i ankesave në #ILD

- ✅ 8536 të konfirmuara
- ✅ 6507 të trajtuara
- ✅ 2029 në proces trajtimi
- ✅ 133 në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar

➡ Më shumë: ild.al
? Keni pasur eksperiencë me ne? Na thoni 🙌👉
ild.al/sq/ankete/



8,536+	6,507	2,029	144
Confirmed Complaints	Processed Complaints	Complaints in the review process	Investigations registered

This information is updated every monday

Thematic and Institutional Inspections

TOTAL INSPECTIONS	COMPLETED INSPECTIONS
21	15

Inspektori i Larte i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

E nevojshme të shndërrojmë çdo praktike të mirë pune në standard të qëndrueshëm, si mjet i shtuar që do i shërbejë forcimit të besimit të qytetarëve tek drejtësia e institucionet. #ILD 🇲🇪 #EU4Justice 🇪🇺 🙌



ILD PËR BASHKËPUNIMIN ME EU4JUSTICE: TË SHNDRËROJME ÇDO...
From ild.al

Inspektori i Larte i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

STAFI I ILD-SË TRAJNIM PËR PËRDORIMIN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË SISTEMIN E DREJTËSISË -




STAFI I ILD-SË TRAJNIM PËR PËRDORIMIN E INTELIGJENCËS ARTIF...
From ild.al

Inspektori i Larte i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

Përpunimi javor i ankesave në #ILD 🇲🇪

- ✅ 8516 të konfirmuara
- ✅ 6486 të trajtuara
- ✅ 2030 në proces trajtimi
- ✅ 130 në proces verifikimi
- ✅ 144 magistratë të hetuar
- ✅ 53 kërkesa për procedim disiplinor

? Keni pasur eksperiencë me ne? Na thoni 🙌👉
ild.al/sq/ankete/



8,516+	6,486	2,030	144
Ankesa të konfirmuara	Ankesa të trajtuara	Ankesa në proces trajtimi	Magjistratë të hetuar
		130	53
		Ankesa në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar	Kërkesa për procedim disiplinor

Ky informacion është rivedikuar çdo të hënë

Inspektime Tematike dhe Institucionale

TOTAL INSPECTIONS	INSPECTIONS TO BE FINISHED
21	15

JANAR 2026


Të gjitha të drejtat e rezervuara
© ILD



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

KONTAKT

WEB: ild.al
TEL: +35542217217
EMAIL: info@ild.al
ADRESA: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
Godina nr. 13, Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)



Më skano!